



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupstina Opstine
Municipal Assambly

**DREJTORIA PER ARSIM DHE KULTURE NE BAZE TE RREGULLORES MF -
NR. 04\2017 MBI KRITERET ,STANDARTET DHE PROGRAMET E FINANCIMIT
PUBLIK TE OJQ -ve**

Fton

Të gjitha OJQ-të - klubet sportive qe veprojnë ne Komune e Istogut të aplikojnë me projekt-propozime për :

1. Përkrahjen e klubeve sportive për zhvillimin e garave kampionale .

Projekt - propozimet duhet të përmbajnë:

Në projekt duhet të janë të përshkruara qartë objektivat, aktivitetet- garat sa me të detalizuara dhe buxheti.

Projekti duhet te jete sa me i specifikuar ne përshkrim pra te ceken ne detale aktivitetet sportive qe klubi ka për ti zhvilluar gjate kampionatit .

Klubet te cilat garat i zhvillojnë ne forme te turneve te ceket vendi i mbajtjes se turneve dhe pjesëmarrja e ekepeve ne ato turne.

Aktivitete qe do te përkrahen nga Komuna :

1. Kotizimi i klubit për garat kampionale .
2. Shpenzimet e transportit për gara .
3. Shpenzimet për personat zyrtare ne gara (refere dhe delegat)
4. Kontrolla mjekësore e Klubit.
5. Licencimi i lojtareve te klubit.
6. Licencën e një trajnerit .
7. Uji për lojtare gjate garave kampionale.

Aktivitetet qe nuk financohen :

1. Pagat e lojtareve
2. Shpenzimet e transportit , personave zyrtare ,kontrolla mjekësore dhe licencimi i grup moshat e reja .
3. Rekuizitat sportive për klube.

Projekt propozimi i dorëzuar duhet te përmbaje :

- Ne projekte duhet te bashkëngjiten dëshmit nga federatat e klubeve për: Kalendarin e garave,deshmin lidhur me kotizimin,licencimin e klubit si dhe dëshmit për personat zyrtare si refer dhe delegat,deshmit duhet te jene te vulosura dhe te nënshkruara nga Federatat përkatëse.
- Një kopje qe posedon regjistrimin e OJQ - së,kopjen e certifikatës fiskale
- Një kopje te llogarisë bankare te OJQ-së dhe kopjen e letërnjoftimit te menaxherit te projektit.

Projekt - propozimet do të vlerësohen nga një komision .

Afati përfundimtar për dorëzimin e projekteve është 15.03.2018.

Projektet që aplikojnë pas këtij termini nuk do të shqyrtohen. Projektet duhet të dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar Nr 100.